

Statistikat e transportit*

Qershor 2021

Tiranë, më 27 Korrik 2021: Volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte, në muajin Qershor 2021 është 412,0 mijë ton, duke u rritur 9,6 %, krahasuar me Qershor 2020. Krahasuar me mesataren e muajve Qershor për periudhën 2018-2020, volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte është rritur 15,7 %.

Në gjashtëmuajorin e vitit 2021, volumi i mallrave të ngarkuara/shkarkuara në porte është 2.345,3 mijë ton, duke u rritur me 15,4 %, krahasuar me gjashtëmuajorin e vitit 2020.

Në muajin Qershor 2021, volumi i mallrave të transportuara me hekurudhë është 2.021 mijë ton-kilometër, duke u ulur 1,3 %, krahasuar me Qershor 2020. Krahasuar me mesataren e muajve Qershor për periudhën 2018-2020, volumi i mallrave të transportuara me hekurudhë është ulur me 17,8 %.

Në gjashtëmuajorin e 2021, volumi i mallrave të transportuar me hekurudhë është 14.952 mijë ton-kilometër, duke u rritur me 23,3 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020.

Tab. 1 Transporti i mallrave me det, hekurudhë dhe ajër

Periudha	Transporti i mallrave		
	Me det / ton	Hekurudhë 000/ton.km	Ajër / ton *
Qershor 2018	277.171	1.584	175.0
Qershor 2019	415.585	3.745	187.8
Qershor 2020	375.972	2.047	123.9
Mesatarja (2018-2020)	356.243	2.459	162.2
Qershor 2021	412.041	2.021	157.4
Janar-Qershor 2020	2.032.754	12.126	844.5
Janar-Qershor 2021	2.345.301	14.952	963.8

* Përfshin mallrat dhe postën

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje të INSTAT

Në muajin Qershor 2021, volumi i mallrave të transportuar me ajër është 157,4 ton duke u rritur 27,1 %, në krahasim me Qershor 2020. Krahasuar me mesataren e muajve Qershor për periudhën 2018-2020, volumi i mallrave të transportuara me ajër është ulur me 3,0 %.

Për publikim 27/07/2021

Në gjashtëmujorin e vitit 2021, volumi i mallrave të transportuar me ajër është 963,8 ton duke u rritur me 14,1 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020.

Në Qershor 2021, numri i fluturimeve të kryera është 2.396 duke u rritur 5,2 herë, në krahasim me Qershor 2020. Krahasuar me mesataren e muajve Qershor për periudhën 2018-2020, numri i fluturimeve është rritur me 33,1 %.

Tab. 2 Treguesit specifike të transportit ajror

Periudha	Numri i shoqërive ajrore*	Numri i fluturimeve	Numri i mbikalimeve
Qershor 2018	20	2.314	19.773
Qershor 2019	21	2.626	21.661
Qershor 2020	17	460	2.443
Mesatarja Qershor (2018-2020)	19	1.800	14.626
Qershor 2021	17	2.396	11.086
Janar- Qershor 2020	17	5.578	33.765
Janar- Qershor 2021	17	8.348	33.896

*Numri i kompanive ajrore i referohet numrit të kompanive të cilat janë licensuar të kryejnë fluturime në fillim të vitit

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ilogaritje të INSTAT

Në Qershor 2021, numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjë detare është 40.902 pasagjerë. Krahasuar me Qershor 2020, ky tregues është rritur 2,3 herë. Krahasuar me mesataren e muajve Qershor për periudhën 2018-2020, numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjë detare është ulur me 58,7 %.

Në gjashtëmujorin e vitit 2021, kanë udhëtuar me linjë detare 196.023 pasagjerë, duke u rritur me 28,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020.

Në muajin Qershor 2021, transporti ajror i pasagjerëve zë 85,7 % të transportit gjithsej.

Numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore, në Qershor 2021 është 260.991 pasagjerë duke u rritur 9,2 herë krahasuar me Qershor 2020. Krahasuar me mesataren e muajve Qershor për periudhën 2018-2020, numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore është rritur me 26,9 %.

Në gjashtëmujorin e vitit 2021, numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me linja ajrore është 756.637 pasagjerë duke u rritur me 36,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020.

Tab.3 Transporti i pasagjerëve sipas mënyrës së udhëtimit

Periudha	Transporti i pasagjerëve		
	Me hekurudhë	Me det	Me ajër
Qershor 2018	7.282	133.037	277.693
Qershor 2019	8.510	146.895	310.988
Qershor 2020	0	17.495	28.416
Mesatarja Qershor (2018-2020)	5.264	99.142	205.699
Qershor 2021	2.803	40.902	260.991
Janar- Qershor 2020	64	152.337	554.877
Janar- Qershor 2021	5.042	196.023	756.637

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ilogaritje të INSTAT

Eksportet/importet e mallrave sipas mënyrës së transportit

Në Qershor 2021, vlera e mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 102,0 mld lekë dhe 47,5 % e tyre u transportua me det. Në gjashtëmujorin e vitit 2021, vlera e mallrave të tregtuara (eksport dhe import) është 530,8 mld lekë dhe 49,1 % e tyre u transportua me det.

Eksportet e mallrave

Në Qershor 2021, mallrat e eksportuara me det zënë 49,8 %, me rrugë 41,2 % dhe me ajër 0,2 %. Mallrat e eksportuara me rrugë në Qershor 2021 janë rritur me 34,2 %, krahasuar me Qershor 2020. Eksportet e mallrave të transportuara me rrugë në Qershor 2021 janë rritur 39,3 %, krahasuar me mesataren e muajve Qershor për periudhën 2018-2020.


Tab.4 Eksporti i mallrave sipas mënyrave të transportit

Periudha	Eksport (mln lekë)				
	Me det	Me hekurudhë	Me rrugë	Me ajër	Të tjera
Qershor 2018	15.313		10.283	96	966
Qershor 2019	14.819	1	9.961	98	686
Qershor 2020	12.171	-	10.706	45	190
Mesatarja (2018-2020)	14.101	0,4	10.316	80	614
Qershor 2021	17.352	-	14.370	84	3.050
Janar-Qershor 2020	70.578	-	52.442	460	1.900
Janar-Qershor 2021	95.562	1	67.145	435	13.487

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Ilogaritje të INSTAT

Në gjashtëmujorin e vitit 2021, mallrat e eksportuara me det zënë 54,1 %, me rrugë 38,0 % dhe me ajër 0,2 %. Mallrat e eksportuara me rrugë janë rritur 28,0 % krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020.

Fig. 1 Struktura e eksporteve sipas mënyrës së transportit, Qershor 2021



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Ilogaritjet të INSTAT

Importet e mallrave

Në Qershor 2021 mallrat e importuara me rrugë zënë 48,6 %, me det 46,2 % dhe me ajër 3,8 %.

Mallrat e importuara me rrugë në Qershor 2021 janë rritur me 29,1 %, krahasuar me Qershor 2020. Importet e mallrave të transportuara me rrugë në Qershor 2021 janë rritur 35,3 %, krahasuar me mesataren e muajve Qershor për periudhën 2018-2020.

Tab.5 Importi i mallrave sipas mënyrave të transportit


Periudha	Import (mln lekë)				
	Me det	Me hekurudh	Me rrugë	Me ajë	Të tjera
Qershor 2018	28.093	219	24.110	1.383	359
Qershor 2019	26.885	284	23.018	1.610	1.628
Qershor 2020	24.618	215	25.312	1.215	774
Mesatarja (2018-2020)	26.532	239	24.146	1.403	920
Qershor 2021	31.063	59	32.670	2.579	804
Janar-Qershor 2020	130.272	1.564	124.666	7.786	7.051
Janar-Qershor 2021	165.102	1.508	170.209	1.876	5.514

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Ilogaritje të INSTAT

Në gjashtëmujorin e vitit 2021, mallrat e importuara me rrugë zënë 48,0 %, me det 46,6 % dhe me ajër 3,4 %. Mallrat e importuara me rrugë janë rritur me 36,5 % krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020.

Për t'u konsultuar me botime të tjera, vizitoni faqen e INSTAT: <http://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%3%ABrbimet/transporti-dhe-aksidentet/>

Fig. 2 Struktura e importeve sipas mënyrës së transportit, Qershor 2021



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, llogaritjet të INSTAT

Metodologjia

Publikimi i Statistikave të Transportit paraqet rezultatet mbi transportin e mallrave dhe pasagjerëve si dhe eksportin dhe importin e mallrave sipas mënyrës së transportit në frekuencë mujore. Të dhënat janë administrative. Burimi kryesor i informacionit është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Përkufizime

Transport: Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave, duke përdorur mjete të ndryshme transporti. Transporti mund të kryhet me mjete të transportit tokësor, ajror dhe detar.

Transporti hekurudhor: Çdo lëvizje e mallrave dhe/pasagjerëve duke përdorur mjete me rrota të drejtuar mbi binarë.

Transport detar: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur anije tregtare në udhëtime të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me det.

Transport ajror: Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur avionë në udhëtime të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me ajër.

Eksportet: Janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues dhe përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet: Janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit, edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Statistikave të Transportit (NST 2007): Është një nomenklaturë statistikore e cila përdoret për mallrat e transportuara nëpërmjet katër mënyrave të transportit: rrugë, hekurudhë, rrugë ujore të brendshme dhe det.

Të dhënat e transportit detar, ajror dhe hekurudhor janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë, referohu: [Politika e Revizionimit Statistikor](#).

Shpjegimi i simboleve

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë

(...) mungesë të dhënash